



RAPORT VJETOR 2023



RAPORT VJETOR 2023

PËRMBAJTJA

7	Hyrje
9	1.BASHKËPUNIMI SHOQËRI CIVILE - QEVERI
9	1.1 Këshilli për Bashkëpunim Shoqëri Civile - Qeveri
9	1.2 Programi për Angazhim Qytetar (Citizen Engagement Activity (CEA))
14	1.3 Përzgjedhja e anëtareve të shoqërisë civile në trupa të ndryshëm publik
15	2. RRITJA E BASHKËPUNIMIT SHOQËRI CIVILE - QYTETARË
15	2.1 Projekti “Përforcimi i Zërave Lokal Përmes Pjesëmarrjes Aktive”
20	2.2 Auditimi Social në Kamenicë, Rahovec, Lipjan dhe Pejë
24	2.3 Rregullimi i një sistemi të qëndrueshëm të kontraktimit të shërbimeve për OJQ
25	3. ZHVILLIMI I BRENDSHËM I SEKRETARIATIT TË PLATFORMËS CIVIKOS DHE SHËRBIMET PËR ANËTARËT
25	3.1 Platforma Kosovo Funding Portal kalon në menaxhim të CiviKos
25	3.2 Mbështetja Institucionale për CiviKos nga Skema e Granteve “Smart Balkans”
26	3.3 Avokimi për politikat kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në Kosovë
27	3.4. Shërbimi informues i Sekretariatit të CiviKos ndaj organizatave anëtare gjatë vitit 2023
28	3.5 Gjetjet e raportit të BE-së për Kosovën 2023

LISTA E AKRONIMEVE

CiviKos	Platforma CiviKos
OSHC	Organizatë e Shoqërisë Civile
ZK	Zyra e Kryeministrit
ZQM	Zyra për Qeverisje të Mirë
Strategjia	Strategjia Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MFPT	Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MD	Ministria e Drejtësisë
AIP	Agjencinë për Informim dhe Privatësi
KCSF	Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile
USAID	The United States Agency for International Development
CEA	Programi për Angazhim Qytetar
NED	National Endowment for Democracy
BE	Bashkimi Evropian
ECNL	European Centre for Not-for-Profit Law
CDF	Community Development Fund

HYRJE

Gjatë vitit 2023, puna e Sekretariatit të CiviKos ka qenë e bazuar në forcim të bashkëpunimit me autoritetet publike, si dhe ofrimin e shërbimeve për organizata anëtare. Angazhimi i Sekretariatit të CiviKos ka synuar të nxisë një mjedis gjithëpërfshirës dhe të përkushtuar ndaj rritjes së transparencës dhe efektivitetit në bashkëpunimin mes shoqërisë civile dhe qeverisë, respektivisht zbatimit të Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2019-2023.

Puna e CiviKos për vitin në fjalë ka përfshirë fuqizimin e rolit të Këshillit për Bashkëpunim në mes të Qeverisë dhe Shoqërisë Civile, duke u angazhuar në përshejtim të zbatimit të aktiviteteve strategjike duke nxitur një dialog produktiv mes të gjithë palëve të interesit. Bashkëpunimi i ngushtë me Agjencinë për Informim dhe Privatësi në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale dhe qasjes në dokumente publike ka sjellë perspektiva të reja duke zgjeruar bashkëpunimin me institucionet publike të Kosovës. Gjithashtu, CiviKos gjatë vitit 2023 ka vazhduar me komponentën e auditimit social në bashkëpunim me DEMOS në katër komuna të Kosovës, duke përfshirë drejtpërdrejtë qytetarët në procese vendimmarrëse.

Përpjekjet e CiviKos kanë reflektuar një angazhim të qëndrueshëm për të shërbyer organizatat anëtare dhe për të krijuar një mjedis sa më të favorshëm për funksionimin e shoqërisë civile në Kosovë. Ky angazhim është realizuar në bashkëpunim të ngushtë me organizatat anëtare dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile, pjesë e Këshillit për Bashkëpunim në mes të Qeverisë dhe Shoqërisë Civile.

Gjatë vitit 2023 CiviKos ka filluar hartimin e legjislacionit sekondar për kontraktimin e shërbimeve për organizata të shoqërisë civile në kuadër të projektit HumanRightivism, i mbështetur nga Ambasada e Suedisë në Prishtinë (Embassy of Sweden in Pristina) përmes Fondit për Zhvillim Komunitar (Community Development Fund - CDF). Kjo përpjekje e CiviKos, Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, Zyrës për Qeverisje të Mirë Zyra e Kryeministrit do të siguroj sistem afatgjatë të kontraktimit të shërbimeve për organizatat ofruese të shërbimeve sociale dhe familjare.

Funksionimi i Sekretariatit të CiviKos është mbështetur nga Granti Institucional nga Smart Balkans dhe nga donatorë të ndryshëm ndërkombëtarë si USAID, NED, SIDA, GIZ, dhe UN. Këto partneritete kanë mundësuar realizimin e projekteve të ndryshme tematike që adresojnë çështje të rëndësishme për shoqërinë kosovare.

1.BASHKËPUNIMI SHOQËRI CIVILE - QEVERI

1.1 Këshilli për Bashkëpunim Shoqëri Civile - Qeveri

Si çdo vit tjetër, edhe gjatë vitit 2023 Platforma CiviKos ka luajtur rol aktiv në thellimin e bashkëpunimit ndërmjet shoqërisë civile dhe institucioneve publike. Sekretariati i CiviKos ka ofruar mbështetjen e vazhdueshme për Këshillin për Bashkëpunim Shoqëri Civile – Qeveri, i cili ka për qëllim forcimin e bashkëpunimit ndërmjet Qeverisë dhe Shoqërisë Civile dhe sigurimin e monitorimit të zbatimit të Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile. Këshilli ka mbajtur tri takime gjatë vitit 2023, të cilat janë organizuar me facilitimin e Platformës CiviKos, në kryesimin e Zëvendës Sekretarit të Përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit, Drejtores Ekzekutive të Platformës CiviKos dhe Zyrës për Qeverisje të Mirë.

Përveç takimeve të rregullta të Këshillit, janë mbajtur edhe takime të ekipeve të punës dhe takime të përbashkëta me koordinatorët e ekipeve. Gjatë vitit 2023, Ekipi 2 (që mbulon fushën e financimit publik të Organizatave Jo-Qeveritare (OJQ)) dhe Ekipi 3 (që mbulon fushën e kontraktimit të OJQ-ve në ofrimin e shërbimeve) e kanë mbajtur nga një takim, ku është diskutuar ndërmarrja e veprimeve nga institucionet, në drejtim të zbatimit të aktiviteteve të parapara brenda objektivave strategjike respektive. Gjithashtu, për t'u koordinuar rreth funksionimit të Këshillit, procesit të zbatimit të Strategjisë, duke përfshirë edhe procesin e vlerësimit, si dhe hapat e nevojshëm për procesin e zhvillimit të strategjisë së re, gjatë vitit 2023 janë mbajtur edhe dy takime të përbashkëta me koordinatorët e ekipeve të punës të Këshillit.



Foto 1: Takimi i rregullt i Këshillit për Bashkëpunim Shoqëri Civile-Qeveri

1.2 Programi për Angazhim Qytetar (Citizen Engagement Activity (CEA))

Gjatë vitit 2023, Platforma CiviKos ka vazhduar me realizimin e aktiviteteve në kuadër të Programit për Angazhim Qytetar (CEA), projekt ky i filluar në vitin 2022, që zbatohet nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (Kosovar Civil Society Foundation (KCSF)) në partneritet me Agjencinë e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) në Kosovë. Platforma CiviKos është partnere e KCSF-së në zbatimin e këtij programi. Këto aktivitete përfshijnë: Udhëheqja e katër grupeve tematike të themeluara nga CiviKos, takimet e rregullta me Sekretarët e Përgjithshëm të ministrive dhe të Zyrës së Kryeministrit, përgatitjen e raporteve periodike të monitorimit të zbatimit të Strategjisë Qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile si dhe procesin e vlerësimit të zbatimit të Strategjisë.

Grupet tematike të shoqërisë civile

Grupet tematike me përfaqësues të shoqërisë civile, të themeluara nga Platforma CiviKos, në linjë me katër objektivat e Strategjisë Qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile kanë zhvilluar punën e tyre përmes mbajtjes së punëtorive në të cilat janë diskutuar zhvillimet që ndërlidhen me objektivat e Strategjisë, duke përfshirë këtu edhe kontributin në dhënien e rekomandimeve për koncept-dokumentet që kanë qenë në proces të konsultimit publik, e të cilat ndërlidheshin me objektivat përkatëse të Strategjisë Qeveritare.

Gjatë vitit 2023 janë mbajtur gjithsej 12 punëtori të rregullta të grupeve tematike, ku secili grup përgjatë këtij viti ka mbajtur nga tri punëtori. Gjatë kësaj kohe, anëtarët e grupeve kanë punuar në identifikimin e mangësive kryesore lidhur me zbatimin e Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2019-2023 dhe dhënien e rekomandimeve për zbatim të saj, si dhe në identifikimin e aktiviteteve që duhet të përfshihen në strategjinë e re. Si rezultat, janë hartuar dy dokumente, të cilat janë dërguar tek Zyra për Qeverisje të Mirë dhe Këshilli për Bashkëpunim Shoqëri Civile-Qeveri:

- Rekomandimet e grupeve tematike në lidhje me zbatimin efektiv të Strategjisë.
- Rekomandimet e grupeve tematike për adresimin e sfidave/problemeve të shoqërisë civile në strategjinë e re.



Foto 2: Grupi tematik 1



Foto 3: Grupi tematik 2



Foto 4: Grupi tematik 3



Foto 5: Grupi tematik 4

Takimet me sekretarët e përgjithshëm të ministrive dhe Zyrës së Kryeministrit

Në kuadër të zbatimit të Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunimin me Shoqërinë Civile, Platforma CiviKos ka dhënë kontributin e saj edhe përmes organizimit të takimeve me Zëvendës Sekretarin e Përgjithshëm në Zyrën e Kryeministrit dhe me sekretarët e përgjithshëm të ministrive kyçe për implementimin e Strategjisë Qeveritare, siç janë: Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve; Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal; Ministria e Punëve të Brendshme; dhe Ministria e Drejtësisë. Këto takime kanë funksionuar si platforma formale të dialogut, ku CiviKos ka bërë avokim për zbatimin efikas të aktiviteteve strategjike, të cilat janë në përgjegjësi të këtyre ministrive. Gjithashtu, këto takime kanë ndihmuar në funksionalizimin e Këshillit për Bashkëpunim shoqëri civile qeveri, ku përfshihen sekretarët e ministrive dhe institucioneve të përmendura më lart. Si pasojë e këtyre përpjekjeve, gjatë vitit 2023, ministrive përgjegjëse u është mundur të nisin zbatimin e disa aktiviteteve kyçe të parapara me Strategjinë Qeveritare për Bashkëpunim shoqëri civile qeveri.



Foto 6: Takimi me Zv. Sekretarin Përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit



Foto 7: Takimi me Sekretaren e Përgjithshme të Ministrisë së Drejtësisë

Hartëzimi i Organizatave të Shoqërisë Civile në Kosovë

Me qëllim të identifikimit të ekspertizës dhe potencialit të Organizatave të Shoqërisë Civile në Kosovë për të kontribuar në zbatimin e Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2019-2023, Platforma Civikos ka hartuar raportin “Hartëzimi i Organizatave të Shoqërisë Civile në Kosovë” në të cilin janë përmbledhur organizatat (anëtare dhe jo-anëtare në CiviKos) sipas fushëveprimit të tyre, bazuar në katër objektivat strategjike të Strategjisë. Raporti është publikuar në muajin shkurt të vitit 2023 dhe mund të gjendet [këtu](#).





Foto 8: Raporti - Hartëzimi i Organizatave të Shoqërisë Civile në Kosovë

Monitorimi i zbatimit Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2019-2023

Plaforma CiviKos, përgjatë gjithë vitit 2023, ka realizuar monitorimin e rregullt të zbatimit të Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2019-2023, duke evidentuar të arriturat dhe mangësitë kryesore në zbatimin e Strategjisë, dhe rekomandimet për përmirësim në këtë proces. Gjetjet nga ky monitorim janë pasqyruar përmes raporteve periodike të cilat përgatiten dhe publikohen çdo gjashtë muaj. Gjatë vitit 2023 janë publikuar dy raporte të monitorimit të Strategjisë, ku gjatë gjysmës së parë të vitit është publikuar raporti me gjetjet për zbatimin e Strategjisë përgjatë vitit 2022, ndërsa gjatë gjysmës së dytë është publikuar raporti me gjetjet për zbatimin e Strategjisë për periudhën janar-qershor 2023.



Foto 9: Raporti i Monitorimit për zbatimin e Strategjisë përgjatë vitit 2022, gjeni [këtu](#).



Foto 10: Raporti i Monitorimit për zbatimin e Strategjisë për periudhën janar-qershor 2023, e gjeni [këtu](#).

Vlerësimi i zbatimit të Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2019-2023

Duke qenë se viti 2023 shënoi vitin e përfundimit të Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile, Platforma CiviKos ka zhvilluar procesin e vlerësimit të zbatimit të Strategjisë. Ky proces është zhvilluar nëpërmjet mbështetjes së dhënë për Zyrën për Qeverisje të Mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, përmes angazhimit të ekspertëve për përgatitjen e raportit të vlerësimit të zbatimit të Strategjisë, raport i cili përmbanë gjetjet lidhur me zbatimin e objektivave të Strategjisë dhe rekomandimet për veprim të mëtutjeshëm në procesin e zhvillimit të strategjisë së re. Gjetjet në këtë raport janë përgatitur bazuar në të dhënat e mbledhura nga Zyra për Qeverisje të Mirë, qoftë përmes të dhënave të ofruara apo përmes raporteve zyrtare të përgatitura, pastaj të dhënat nga raportet dhe dokumentet nga institucionet tjera relevante, raportet e monitorimit të zbatimit të Strategjisë të përgatitura nga

Platforma CiviKos, si dhe raportet tjera relevante të përgatitura nga CiviKos dhe organizatat tjera të shoqërisë civile në Kosovë. Ekspertët po ashtu kanë zhvilluar intervista individuale me përfaqësues të institucioneve dhe përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile në Kosovë. Për ta përmbyllur këtë proces, në muajin tetor është mbajtur edhe një fokus grup, me përfaqësues të akterëve relevantë nga institucionet dhe shoqëria civile (duke përfshirë përfaqësuesit e grupeve tematike të themeluara nga CiviKos), ku janë prezantuar gjetjet fillestare të vlerësimit dhe me këtë rast është bërë validimi i këtyre gjetjeve dhe janë marrë rekomandimet për veprim të mëtutjeshëm.



Foto 11: Fokus grupi me përfaqësues të shoqërisë civile dhe të institucioneve

1.3 Përzgjedhja e anëtareve të shoqërisë civile në trupa të ndryshëm publik

Sekretariati i Platforma CiviKos edhe gjatë vitit 2023 me kërkesë të institucioneve të ndryshme publike ka lehtësuar përzgjedhjen e anëtareve të shoqërisë civile në trupa të ndryshëm publik.

Gjatë vitit 2023 CiviKos ka lehtësuar përzgjedhjen e anëtareve të shoqërisë civile për këto institucione publike:

- Thirrje për nominime nga OSHC-të për përfaqësues të shoqërisë civile në Këshillin për Demokraci dhe të Drejta të Njeriut nga Zyra e Presidentes të Republikës të Kosovës;
- Përzgjedhjen e (2) përfaqësuesve të shoqërisë civile si pjesëmarrës të procesit të vlerësimit të granteve dhe subvencioneve për vitin 2023 në Komunën e Prishtinës;
- Përzgjedhjen e dy anëtarëve të shoqërisë civile për Bordin e Llogarisë së Sfidave të Mijëvjeçarit LLSM-Kosovë, udhëhequr nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve;
- Përzgjedhjen e përfaqësuesve të shoqërisë civile në grupin punues për hartimin e konceptit për themelimin e Muzeut për Dokumentimin dhe Prezantimin e Krimeve të ish-Jugosllavisë dhe Serbisë ndaj shqiptarëve në Kosovë;
- Përzgjedhjen e përfaqësuesve të shoqërisë civile në komisionin vlerësues të procesit dhe verifikimit të aplikacioneve të OJQ-ve për të hyrë në partneritet me Agjencia për Ndhimë Juridike Falas (ANJF) udhëhequr nga Ministria e Drejtësisë;
- Përzgjedhjen e përfaqësuesve të shoqërisë civile në Komitetet e Përbashkëta Monitoruese të tri programeve të Bashkëpunimit Ndërkufitar, me Shqipërinë, Malin e Zi, dhe Maqedoninë e Veriut, udhëhequr nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal;
- Përzgjedhjen e përfaqësuesit rinor të Kosovës në Bordin Drejtues të Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor (RYCO), udhëhequr nga Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit.

2. RRITJA E BASHKËPUNIMIT SHOQËRI CIVILE - QYTETARË

2.1 Projekti “Përforcimi i Zërave Lokal Përmes Pjesëmarrjes Aktive”

Fillimviti 2023 përfshinte një seri takimesh kooordinuese me partnerë të ndryshëm për të planifikuar aktivitetet dhe çështjet në të cilat Platforma CiviKos do të mund të kontribuonte në kuadër të projektit “Përforcimi i Zërave Lokal Përmes Pjesëmarrjes Aktive”. Ky projekt, i financuar nga National Endowment for Democracy (NED), ka për qëllim ngritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje lokale dhe rritjen e bashkëpunimit në mes organizatave me bazë në komunitet, qytetarëve aktiv dhe institucioneve publike lokale. Në shtatorin e vitit 2022, projekti aprovohet për vazhdimin e aktiviteteve edhe për një vit tjetër duke përfshirë edhe 6 komuna të tjera, dhe në shtator 2023, projekti vazhdohet me një plan dy veçar. Gjegjësisht, deri në tetor të vitit 2025.

Bashkëpunimi me institucionet qendrore

Një ndër komponentët kryesore të këtij projekti që nga fillimi i tij është bashkëpunimi me Agjencinë për Informim dhe Privatësi (AIP). Ndër aktivitetet e para në kuadër të këtij bashkëpunimi për këtë vit ishte krijimi i infografikave vetdijësuese rreth mandatit të AIP-së dhe dy ligjeve të cilat AIP i monitoron, për të informuar drejt qytetarët dhe OJQ-të në lidhje me këto fusha dhe çështjet që mund të adresohen në AIP. Këto materiale u shpërndanë në rrjetet sociale dhe gjatë diskutimeve regjionale që CiviKos, AIP dhe organizatat anëtare




Foto 12: [Materialet informuese rreth AIP-së](#)

të Civikos organizuan në 7 regjionet e Kosovës. Gjegjësisht, në Gjilan, Ferizaj, Mitrovicë, Pejë, Gjakovë, Prizren dhe Prishtinë.



Foto 13: Diskutimi informues në regjionin e Gjilanit

Cikli i diskutimeve informuese regjionale filloi me regjionin e Gjilanit. Ngjarja njëkohësisht shënoi Javën e Privatësisë me një paneli të përbërë nga Komisionerja e AIP-së, znj. Krenare Sogojeva Dermaku dhe Kryetari i Komuna e Gjilanit, z. Alban Hyseni.

Përfaqësuesit e organizatave lokale, bizneseve, dhe qytetarë të tjerë aktiv nga regjionet përkatëse treguan interesim të jashtëzakonshëm për të njohur mirë të drejtat e tyre, çështjet e mbrojtjes së të dhënave personale dhe procedurat e parashtrimit të ankesave si dhe kërkesave për qasje në dokumente publike.



Foto 14: Paneli gjatë diskutimit informues në Regjionin e Gjilanit

Cikli i diskutimeve regjionale informuese u përmbyll me regjionin e Prishtinës, dhe bashkë me të edhe një vit i suksesshëm i këtij projekti. Ngjarja përkoi edhe me shënimin e Javës së Qasjes në Dokumente Publike dhe publikimin e raportit Analizë e Kornizës Ligjore dhe Implementimin në Praktikë të dy fushave që mbulon Agjencia për Informim dhe Privatësi. Gjegjësisht, Qasjes në Dokumente Publike dhe Mbrojtjes të të Dhënave Personale (Raportin gjeni [këtu](#)).

Panelistët e këtij diskutimi ishin znj. Krenare Sogojeva Dermaku, Komisionere e AIP-së, z. Lulzim Rafuna, Kryetar i Odës Ekonomike e Kosovës, dhe z. Qerkin Berisha, eksperti ligjor i angazhuar për përpilimin e raportit. Panelistët dhe të pranishmit diskutuan përvojat, sfidat dhe nevojat e sektorit publik, privat, dhe shoqërisë civile rreth zbatueshmërisë më të mirë të ligjeve që mbikqyrë AIP si dhe mundësitë e bashkëpunimit shumëpalësh.



Foto 15: Paneli gjatë diskutimit informues në Regjionin e Prishtinës



Foto 16: Diskutimi informues në Regjionin e Prishtinës



Foto 17: Raporti - Analizë e Kornizës Ligjore dhe Implementimin në Praktikë të dy fushave që mbulon AIP

Promovimi i Platformës KerkoQasje.com

Gjatë këtij viti, Platforma CiviKos vazhdoi përditësimet në platformën KerkoQasje për të ruajtur relevancën dhe rritur përdorimin e saj, në koordinim me AIP-në. Drejt këtij qëllimi, janë zhvilluar materiale dhe [video promovuese](#) për kanalet digjitale të komunikimit. Përpos kësaj, CiviKos ka prezantuar platformën KerkoQasje në POINT Conference në Sarajevë, si platformën për lehtësimin e kërkesave për qasje në dokumente publike. Kjo konferencë, më e madhja e llojit të saj në regjion, ka qëllim promovimin e angazhimit të shoqërisë civile dhe përdorimit të teknologjisë për transparencë dhe llogaridhënjë.



Foto 18: Prezantimi i platformës KerkoQasje.com në Konferencën Point në Sarajevë

Bashkëpunimi me qeverisjet lokale dhe organizatat lokale

Komponenti kryesor i këtij projekti ishte puna në terren me qytetarë aktiv, organizata lokale, Këshilla të Fshatrave dhe Lagjeve, si dhe qeveritë lokale. Gjegjësisht, viti i dytë i këtij projekti parashihte këtë punë në gjashtë qytete të tjera target: Dardanë, Fushë Kosovë, Vushtri, Mitrovicë, Klinë dhe Gjakovë. Para çfarëdo planifikimi aktivitetesh në këto komuna, Platforma CiviKos fillimisht kishte përzgjedhur organizatat anëtare nga këto komuna si partner të implementimit të aktiviteteve: OJQ Access, CBM, OJQ Zana dhe NOPM.



Foto 19: Takimi në Dardanë

Pas koordinimeve të para me organizatat partnere, ekipi i CiviKos u takua edhe me zyrtarët komunal të secilës komunë target për t'i njoftuar ata me qëllimet dhe aktivitetet e projektit. Diskutimet kishin në fokus bashkëpunimin me shoqërinë civile lokale për ngritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimarrje lokale, por edhe përputhshmërinë e nivelit lokal me standardet minimale të konsultimit publik, siç parasheh niveli qendror. Pas këtyre takimeve,

është vërejtur se disa nga komunat kanë filluar të publikojnë dokumentet dhe thirrjet e tyre për konsultim publik në platformën elektronike.



Foto 20: Takimi në Vushtri



Foto 21: Takimi në Mitrovicë

Punëtoritë dyditore me përfaqësues të Këshillave Lokale dhe organizatave të shoqërisë civile

Gjatë periudhës mars-qershor, Platforma CiviKos në bashkëpunim me organizatat partnere nga komunat target të projektit ka organizuar punëtoritë dyditore me përfaqësues të Këshillave të Fshatrave dhe Lagjeve dhe orgnizatave lokale. Qëllimi i tyre ishte rritja e njohurive rreth mekanizmave të pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset vendimmarrëse në nivel lokal, dhe mënyrat e avokimit dhe ndikimit të politikave në nivel lokal. Këto punëtori i kanë shërbyer përgatitjes për dëgjimet buxhetore komunale që kanë filluar në qershor dhe janë finalizuar në shtator. Me perfundimin e serisë së punëtorive dhe monitorimit të degjimeve buxhetore, Platofrma CiviKos ka përgatitur materiale informuese me qëllim ngritjen e ndërgjegjësimit të qytetarëve për rëndësinë e proceseve vendimmarrëse lokale.



Foto 22: Punëtoritë dyditore në Komunën e Mitrovicës



Foto 23: Punëtoritë dyditore në Komunën e Fushë Kosovës

PUNËTORITË MBI NGRITJEN E PJESËMARRJES SË QYTETARËVE NË PROCESET VENDIMMARRËSE LOKALE



Foto 24: Të dhëna nga punëtoritë dyditore në 6 komunat e targetuara

2.2 Auditimi Social në Kamenicë, Rahovec, Lipjan dhe Pejë

Platforma CiviKos me mbështetje të projektit për Decentralizim dhe Përkrahje të Komunave (DEMOS), projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) bashkëfinancuar nga Suedia dhe Norvegjia, dhe zbatuar nga HELVETAS Swiss Intercooperation-Kosovo, ka mbështetur katër grupe të qytetarëve në katër komunat partnere Pejë, Lipjan, Kamenicë dhe Rahovec për të monitoruar 4 projekte kapitale të mbështetura nga granti i performancës.

Auditimi social si një mjet për të kërkuar llogaridhënie qytetare tek autoritetet komunat është bazuar në parimet themelore të qeverisjes demokratike dhe të mirë, që do të thotë se procesi ka qenë pjesëmarrës, gjithëpërfshirës, transparent, me qasje në informatat e nevojshme, dhe se vendimmarrësit dhe politike-bërësit mbahen përgjegjës.

Projektet e përzgjedhura në kuadër të Auditimit Social

Katër projektet nga katër komunat partnere, Pejë, Kamenicë, Rahovec, dhe Lipjan që janë përzgjedhur për auditim social janë:

- Rregullimi i Parkut Karagaç në Komunën e Pejës;
- Projekti për shpërndarjen e ujit për fshatrat Hogosht dhe Lisockë në Komunën e Kamenicës;
- Ndërtimi i infrastrukturës për persona me nevoja të veçanta në Komunën e Rahovecit (Rahovec, Xërxë, Fortesë, Krushë e Madhe, Celinë, Hoqë e Vogël, Opterushë, Malësi e Vogël, Ratkoc, Dejn dhe Qifllak); dhe
- Ndërtimi i Rezervuarit të Ujit dhe Rehabilitimi i Rrjetit të Ujësjetës në Janjevë në Komunën e Lipjanit.

Publikimi i raporteve të Auditimit Social në katër komuna partnere

Pas finalizimit të raporteve të Auditimit Social të mbështetura nga Demos në katër komunat ku grupet e qytetarëve kanë monitoruar projektet kapitale CiviKos organizoi prezantimet e rezultateve të katër raporteve të auditimit social në komunat e synuara: Kamenica, Peja, Rahovec dhe Lipjan. Këto prezantime u mbajtën në ambiente të ndryshme si sallat e Asambleve Komunale dhe Zyrat e Kryetarëve, me pjesëmarrjen e anëtarëve të ekipit të auditimit social, aktivistëve të shoqërisë civile dhe organizatave lokale, duke siguruar pjesëmarrje dhe angazhim të gjerë.




Foto 25: Raporti dhe Infografika “Rregullimi i Parkut Karagaç në Komunën e Pejës”

CiviKos në bashkëpunim me DEMOS, pas një sërë prezantimesh në komunat përkatëse kanë publikuar katër raportet e Grupeve të Auditimit Social. Në Pejë u publikua raporti “Rregullimi i Parkut Karagaç”, një hapësirë jetike për rekreacionin e banorëve. Në Lipjan, u prezantua raporti për projektin e monitoruar “Ndërtimi i Rezervuarit të Ujit dhe Rehabilitimi i Rrjetit të Ujësjetës në Janjevë”, që synon të përmirësojë furnizimin me ujë për banorët. Në




Foto 26: Raporti dhe Infografika: “Shpërndarja e ujit për fshatrat Hogosht dhe Lisockë në Komunën e Kamenicës”

Rahovec u publikuar raporti “Ndërtimi i Infrastrukturës për Persona me Nevoja të Veçanta (Rahovec, Xërxë, Fortesë, Krushë e Madhe, Celinë, Hoqë e Vogël, Opterushe, Malësi e Vogël, Ratkoc, Dejn dhe Qifllak” duke u përqendruar në përmirësimin e infrastrukturës për persona më nevoja të veçanta. Në Kamenicë, u publikua raporti Shpërndarjen e ujit për fshatrat Hogosht dhe Lisockë në Komunën e Kamenicës duke theksuar rëndësinë e furnizimit me ujë të pijshëm për fshatrat Hogosht dhe Lisockë. Këto raporte kanë sjellë tek komunat përkatëse perspektiven e qytetarëve të Kosovës që përmes procesit të Auditimit Social kanë monitoruar projektet e ndryshme kapitale.




Foto 27: Raporti dhe Infografika “Ndërtimi i Rezervuarit të Ujit dhe Rehabilitimi i Rrjetit të Ujësjellësit në Janjevë në Komunën e Lipjanit”

Promovimi i raporteve dhe monitorimi i adresimit të gjetjeve të qytetareve nga katër komunat përkatëse

CiviKos promovoi raportet e Auditimit Social përmes buletinit javor dhe mediave sociale, duke krijuar infografika për secilin raport duke përmblendhur gjetjet kryesore dhe rekomandimet. Këto infografika u ndanë me 290 organizatat anëtare përmes buletinit që dërgohet çdo javë në 500 adresa elektronike. Përveç kësaj, CiviKos përdori faqen e sajë në Facebook për të ndarë raportet e plota dhe infografikat, duke synuar të rrisë ndërgjegjësimin dhe të angazhojë një audiencë më të gjerë në rëndësinë dhe ndikimin e raporteve të auditimeve sociale në katër komunat.



Foto 28: Raporti dhe Infografika: “Ndërtimi i infrastrukturës për persona me nevojë të veçanta në Komunën e Rahovecit”

Pas publikimit të katër raporteve të Auditimit Social në katër komunat partnere CiviKos me mbështetje të Demos mori hapa për të ndjekur përparimin dhe siguruar që rekomandimet të zbatoheshin në katër komunat. Ky proces i mbledhjes së të dhënave synoi të ofronte njohuri të vlefshme mbi efektivitetin e procesit të auditimit social dhe të kontribuonte në përmirësimin e vazhdueshëm të praktikave të qeverisjes.

- Raportin e plotë “Shpërndarja e ujit për fshatrat Hogosht dhe Lisockë në Komunën e Kamenicës” mund ta gjeni [këtu](#).
- Raportin e plotë: “Rregullimi i Parkut Karagaç në Komunën e Pejës” mund ta gjeni [këtu](#).
- Raportin e plotë “Ndërtimi i infrastrukturës për persona me nevojë të veçanta në Komunën e Rahovecit (Rahovec, Xërxë, Fortesë, Krushë e Madhe, Celinë, Hoqë e Vogël, Opterushë, Malësi e Vogël, Ratkoc, Dejn dhe Qifllak); mund ta gjeni [këtu](#).
- Raportin e plotë “Ndërtimi i Rezervuarit të Ujit dhe Rehabilitimi i Rrjetit të Ujësjetës në Janjevë në Komunën e Lipjanit” mund ta gjeni [këtu](#).

2.3 Rregullimi i një sistemi të qëndrueshëm të kontraktimit të shërbimeve për OJQ

CiviKos në përpjekjet e saj për të avancuar dialogun dhe bashkëpunimin midis shoqërisë civile dhe qeverisë filloi projektin e ri me Fondin për Zhvillim Komunitar (CDF), i financuar nga Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA), në kuadër të projektit Human Rightivism. Ky projekt ka për qëllim të krijoj legjislacionin sekondar për procesin e kontraktimit të shërbimeve për OJQ.

Një nga hapat kryesorë në kuadër të këtij bashkëpunimi është themelimi i grupit punues nga Ministria e Financave, i përbërë nga anëtarë të qeverisë dhe përfaqësues të shoqërisë civile. Ky grup punues ka mandat të hartoj legjislacionin sekondar për procesin e kontraktimit të shërbimeve në Kosovë.

Punëtorja e parë, e mbajtur më 2 dhjetor në Vila Germia, shënoi fillimin zyrtar të hartimit të Udhëzimit Administrativ për procesin e kontraktimit të shërbimeve nga ana e OJQ-ve në Kosovë.



Foto 29: Punëtorja e mbajtur në dhjetor 2023



Foto 30: Punëtorja e mbajtur në dhjetor 2023

3. ZHVILLIMI I BRENDSHËM I SEKRETARIATIT TË PLATFORMËS CIVIKOS DHE SHËRBIMET PËR ANËTARËT

3.1 Platforma Kosovo Funding Portal kalon në menaxhim të CiviKos

Më 1 Mars 2023, Platforma CiviKos organizoi një ngjarje për kalimin e Kosovo Funding Portal nga misioni i OSBE-së në Kosovë të cilët e kishin zhvilluar portalin tek partneri vendor Platforma CiviKos.



**Kosovo
Funding
Portal**

Kjo platformë, e para në llojin e saj në Kosovë, synon të rrisë aksesin dhe transparencën e mundësive të financimit për organizatat e shoqërisë civile. Është një mjet i thjeshtë për përdoruesit që bashkon donatorët dhe organizatat e shoqërisë civile në një vend.

Ne këtë ngjarje ishin donator te ndryshëm, përfaqësues te organizatave të shoqërisë civile dhe gazetarë. Ky portal u dorëzua tek CiviKos nga Ambasadori i OSBE-së në Kosovë Michael Davenport. Pjesëmarrësit theksuan rëndësinë e rritjes së aksesit të mundësive të financimit për të gjitha organizatat e shoqërisë civile, duke përfshirë ato të vogla dhe të mesme që operojnë në nivelin baze, si dhe organizatat që përfaqësojnë komunitetet jo-shumicë dhe grupet e cënueshme.

Portali i Financimit përmban informacione për donatorët për grante dhe informacione të tjera për shoqërinë civile në Kosovë. Ai ofron një bazë të dhënave për donatorët dhe përdoruesit. Të gjitha organizatat e shoqërisë civile, qytetarët dhe gazetarët mund të regjistrohen falas, si dhe donatorët mund të regjistrohen falas. Ky portal është mundësuar nga Skema e grantit institucional Smart Balkans. Portali Kosovo Funding mund të qaset në: kosovofunding.org

3.2 Mbështetja Institucionale për CiviKos nga Skema e Granteve “Smart Balkans”

Granti Institucional i financuar nga Smart Balkans ka qenë një faktor kyç në mbështetjen e Platforma CiviKos për të realizuar një sërë përmirësimesh dhe zgjerimesh të kapaciteteve të saj.

Kjo mbështetje financiare ka bërë të mundur përditësimin e dokumentacionit të brendshëm, duke përfshirë politikat dhe procedurat që rregullojnë funksionimin e organizatës. Ky proces ka ndihmuar në rritjen e transparencës dhe në forcimin e strukturave të brendshme të menaxhimit dhe llogaridhënies.

Veç përditësimit të dokumentacionit, granti ka mundësuar që CiviKos të përmirësojë dhe zgjerojë shërbimin e saj informues. Kjo ka mundësuar ofrimin e informacionit më cilësor dhe të qashtë për anëtarët dhe partnerët, duke përfshirë shpërndarjen e buletineve dhe përditësimin e faqes së internetit të organizatës për të reflektuar ndryshimet dhe risitë.

Një ndër arritjet më të rëndësishme me ndihmën e këtij granti ka qenë menaxhimi dhe operimi i Kosovo Funding Portal. Kjo platformë ka për qëllim të thjeshtojë qasjen në informacion për

organizatat e shoqërisë civile në Kosovë, duke ofruar një bazë të dhënave të pasur për mundësitë e financimit dhe duke bashkuar donatorët me organizatat që kërkojnë fonde.

Përditësimi i dokumenteve dhe procedurave të brendshme të CiviKos

CiviKos në kuadër të grantit institucional të mbështetur nga Smart Balkans ka bërë përditësimin e dokumenteve dhe procedura të brendshme të CiviKos duke siguruar zbatimin e standardeve transparente dhe llogaridhënese për menagjim efektiv të sekretariatit.

Përditësimi i Dokumenteve të Brendshme: CiviKos ka përfunduar dhe përmirësuar dokumentacionin për funksionimin e brendshëm. Kjo ka përfshirë hartimin e Rregullores Financiare dhe të Prokurimit, të cilat përfshijnë procedurat dhe standardet e fundit duke siguruar transparencë dhe llogaridhënie të rritur.

3.3 Avokimi për politikat kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në Kosovë

Platforma CiviKos me mbështetje të organizatës Human Security Collective edhe gjatë vitit 2023 ka vazhduar me aktivitetet avokuese në fushën e politikave kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, si dhe ndikimit në punën e shoqërisë civile në Kosovë.

Seminari dy-ditor mbi Rreziqet e Financimit të Terrorizmit

Platforma CiviKos me 6 dhe 7 shkurt 2023 mori pjesë në një seminar që synonte vlerësimin e të dhënave mbi rreziqet e financimit të terrorizmit brenda organizatave jo-fitimprurëse. Seminari, i cili ishte pjesë e Projektit Kundër Krimit Ekonomik në Kosovë (PECK III), u fokusua në mbështetjen e kontribuesve kyç në mbledhjen e informacioneve për një vlerësim të detajuar të rreziqut të sektorit të OSHC-ve në Kosovë, duke përdorur Metodologjinë e Këshillit të Europës.

Broshura Informative mbi Politikat Globale

CiviKos përgatiti një broshurë që trajton ndikimin e politikave globale kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit mbi organizatat jo-qeveritare. Kjo broshurë përfshiu aspekte të ndryshme, duke përfshirë rekomandimet e FATF, kuadrin ligjor në Kosovë dhe udhëzimet për OJQ-të për të mbrojtur veten nga abuzimi për financim të terrorizmit, [këtu](#).



Foto 31: Broshurë Informuese

Avokimi për politikat kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në Kosovë

Platforma CiviKos me mbështetje të organizatës Human Security Collective ka vazhduar me aktivitetet avokuese në fushën e politikave kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, si dhe ndikimit në punën e shoqërisë civile në Kosovë.

Me 3 nëntor 2023 CiviKos organizoi punëtorinë “Politikat kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në Kosovë”- Ndikimi në punën e OSHC-ve në Kosovë.

Kjo punëtori është udhëhequr nga z. Dren Puka nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF), njëherit edhe anëtarë i grupit punues për plotësim ndryshimin e legjisllacionit kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në Kosovë.

Pjesëmarrësit kishin mundësi të informoheshin rreth politikave kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në Kosovë, dhe ndikimin që këto politika kanë në punën e shoqërisë civile. Po ashtu gjatë punëtorisë u diskutua rreth vlerësimit të rrezikut sektorial, dhe rëndësisë së pjesëmarrjes së organizatave të shoqërisë civile në këtë proces të vlerësimit që Kosova është duke e kaluar.



Foto 32: Politikat kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në Kosovë - Punëtori

3.4. Shërbimi informues i Sekretariatit të CiviKos ndaj organizatave anëtare gjatë vitit 2023

Sekretariati i CiviKos gjatë vitit 2023 ka ofruar buletin e rregullt javor për organizatat anëtare. Buletini javor me informata si; mundësi për grante, mundësi për pjesëmarrje në trajnime, seminare të ndryshme, mundësi rrjetëzimi, si dhe informata relevante për shoqërinë civile është dërguar tek organizatat anëtare në baza javore përgjatë gjithë vitit.

CiviKos ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm për të zhvilluar dhe përmirësuar shërbimet e saj për organizatat anëtare, duke përfshirë:

- **Përmirësimi i Shërbimit Informues:** Bazuar në rezultatet e hulumtimit të kryer përmes pyetësorit, CiviKos ka bërë përmirësime të duhura në shërbimin informues. Kjo ka përfshirë kanalizimin e informacionit dhe përmirësimin e dizajnit të buletinit javor.
- **Ristrukturimi i Buletinit Javor:** Buletini javor është ristrukturuar dhe i është dhënë një dizajn i ri për të rritur volumin dhe cilësinë e informacioneve të dërguara. Përdorimi i Mailchimp ka mundësuar ofrimin e një dizajni më miqësor për përdoruesit.

CiviKos ka organizuar takime fokus grupi dhe individuale me organizatat anëtare, si p.sh. takimi në rajonin e Gjilanit, për të marrë mendimin dhe kontributin e tyre rreth shërbimeve të ofruara. Po ashtu takime individuale janë mbajtur me organizata anëtare për të marrë mendimin e tyre rreth përmirësimit të shërbimeve.

- Gjatë vitit 2023 janë dërguar 52 buletine tek organizatat anëtare.

Në kuadër të përpjekjeve për të zgjeruar dhe thelluar bashkëpunimin me institucione të ndryshme dhe për të rritur vlerën e shërbimeve të ofruara për organizatat anëtare, CiviKos ka ndërmarrë hapa konkretë në bashkëpunim me Zyrën për Komunitete në Zyrën e Kryeministrit të Kosovës. Më 4 Maj 2023, një takim i kordinues u zhvillua mes Platformës Civikos dhe përfaqësuesve të Zyrës së Kryeministrit, përfshirë Znj. Elizabeth Gowing, Këshilltare e Kryeministrit për Çështjet e Komuniteteve, dhe Manuela Petrovic, Asistente në Zyrën e Kryeministrit për Çështje të Komuniteteve.

Gjatë takimit u diskutua për bashkëpunimin dhe ndarjen e informacioneve relevante për shoqërinë civile, veçanërisht në lidhje me grante të ofruara nga Qeveria e Kosovës.

Përfshirja e këtyre informacioneve në buletin javor të CiviKos, dhe me vonë përfshirjen në portalin Kosovo Funding Portal do të ndihmojë në ngritjen e ndërgjegjësimit dhe në lehtësimin e qasjes të organizatave anëtare në këto burime, duke kontribuar në forcimin e kapaciteteve të tyre dhe në realizimin e projekteve që synojnë të adresojnë nevojat dhe sfidat e komuniteteve të ndryshme në Kosovë.



*Foto 33: Takim me përfaqësues të Zyra për Çështjet e Komuniteteve
- Zyra e Kryeministrit të Kosovës*

3.5 Gjetjet e raportit të BE-së për Kosovën 2023

Sekretariati i CiviKos ka përmbledhur në një infografikë të veçantë të gjeturat e raportit të Bashkimit Evropian (BE) për Kosovën, respektivisht mesazhet kryesore për shoqërinë civile.

MESAZHET KRYESORE TË RAPORTIT TË PROGRESIT PËR SHOQËRINË CIVILE (SHC) PËR VITIN 2023



TË PËRGJITHSHME - FUNKSIONIMI I SHOQËRISË CIVILE NË KOSOVË

Në përgjithësi, shoqëria civile operon në një mjedis të favorshëm. Shoqëria civile vazhdon të marrë pjesë aktivisht në konsultimet publike dhe kontribuon në proceset politikëbërëse dhe monitoruese. Përpjekjet e autoriteteve publike për të përfshirë publikun në proceset vendimmarrëse janë të mirëpritura dhe duhet të rriten edhe më tutje. Qeveria duhet të sigurojë që çdo proces i konsultimit publik të përmbushë standardet minimale, parimet dhe procedurat e vendosura nga rregullorja relevante. Duhet të mirëmbahen përpjekjet për rritjen e transparencës dhe llogaridhënies në financimin publik të organizatave të shoqërisë civile.



RRETH ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE

Një shoqëri civile e fuqizuar është komponent kyç i çdo sistemi demokratik dhe vazhdon të njihet si e tillë nga institucionet publike. Shoqëria civile mbetet një partner i rëndësishëm në kornizën e përgatitjes së Kosovës për anëtarësim në BE, duke qenë se kontribuon në dizajnimin, zbatimin dhe monitorimin e reformave që ndërliken me BE-në, dhe merr pjesë në platformat e politikave dialoguese të Stabilizim Asociimit. Roli i saj në promovimin e ndryshimit social, duke ndërtuar besimin dhe promovuar bashkëpunimin shumëpalësh është gjerësisht i pranuar. Shoqëria civile gjithashtu luan rol kritik në avokimin për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, barazinë gjinore, dhe të drejtat e personave që ju takojnë komuniteteve jo-shumicë.

BASHKËPUNIMI SHOQËRI CIVILE - QEVERI

Përveç disa përparimeve në procesin e konsultimit publik, nuk ka zhvillime signifikante në zbatimin e Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2019-2023.



KONSULTIMI PUBLIK

Qeveria ka bërë disa përpjekje për të përfshirë shoqërinë civile në politikëbërje. Në vitin 2022, platforma online për konsultime publike është avancuar me disa elemente duke facilituar pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara. Shumica e akteve legjislative të miratuara nga qeveria janë vendosur për konsultim publik. Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC-të), palët e interesuara dhe publiku janë angazhuar në konsultimet publike në nivelin qendror pothuajse katër herë më shpesh se në vitin 2021. Në të njëjtën kohë, zbatimi i disa standardeve, parimeve dhe procedurave të specifikuar në Standardet Minimale të Konsultimit Publik ka vazhduar të ngecë. Konsultimet publike në përgjithësi janë realizuar në nivelin qendror, në formë të shkruar dhe atë elektronike përmes platformës online. Rekomandohet që të rritet përdorimi i formave tjera të konsultimit publik. Institucionet lokale nuk i përdorin mjaftueshëm këta mekanizma.

FINANCIMI PUBLIK

Zbatimi i Rregullores për Financimin Publik të OJQ-ve është duke u përmirësuar gradualisht. Përkundër përfshirjes në agjendën legjislative të vitit 2022, ndryshimet e Rregullores nuk janë inicuar. Platforma online është avancuar me vizualizim të të dhënave bazuar në ofruesit, përfituesit dhe territorin e zbatimit, dhe tani është e lidhur me Platformën për Mbështetjen e Donatorëve ndaj Shoqërisë Civile. Kosova mund të përfitojë nga rritja e transparencës dhe llogaridhënies në financimin publik për OJQ-të. Nevojiten më shumë përpjekje për të përditësuar regjistrin e OJQ-ve dhe për të siguruar që sistemi elektronik i i organizatave jo-qeveritare të Kosovës është plotësisht i besueshëm.



VULLNETARIZMI

Ambienti për vullnetarizëm duhet të përmirësohet, përfshirë zhvillimin e një kornize të përshtatshme legjislative, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe duke ndarë resurse financiare dhe humane për programet e vullnetarizmit për rininë.

KORNIZA LIGJORE PËR PARANDALIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE DHE FINANCIMIN E TERRORIZMIT

Në vitin 2022, qeveria inicioi procesin e vlerësimit të rrezikut sektorial të financimit të terrorizmit për organizatat jo-qeveritare, duke përfshirë shoqërinë civile. Kjo punë duhet të përfshihet në rishikimin e Ligjit për parandalimin e pastrimit të parasë dhe financimit të terrorizmit. Qëllimi është që të hiqen barrierat e panevojshme për raportim të OSHC-ve, të zbuten masat e tepërta kontrolluese për OJQ-të me rrezik të ulët, të hiqen kufizimet në dhurimet në para të gatshme, dhe të eliminohen barrierat në qasjen në shërbimet bankare dhe financiare. Regjimi tatimor për OSHC-të konsiderohet se i plotëson pjesërisht standardet relevante bazuar në vlerësimin bazë për vitin 2021 të Asistencës Teknike të BE-së për Organizatat e Shoqërisë Civile (TACSO).



* Mesazhet kryesore të gjeturave të Raportit të Progresit për vitin 2023 për sektorin e shoqërisë civile janë përkthyer dhe përshtatur nga Sekretariati i Civikos për nevoja të organizatës dhe nuk është përkthim zyrtar i Komisionit European.

Foto 34: Infografika “Mesazhet kryesore të Raportit të Progresit për SHC, 2023”

